

# POLICY BRIEF

## **Rritja e përfshirjes së komuniteteve rurale bregdetare në administrimin e plazheve të Rivierës Shqiptare**

Një model zhvillimi i qendrueshëm  
bazuar në vendim-marrjen zakonore

Admir Malaj\*  
Ervis Moçka  
Oljan Kanushi

\*Renditja bëhet në rend alfabetik sipas emrit.



## **A mund të ndërtohet një model zhvillimi i qendrueshëm bazuar në vendim-marrjen zakonore?**

Komunitetet e njësive administrative bregdetare në jug të vendit (nga këtu komunitetet bregdetare) janë dëshmitarë të zhvillimit dhe vlerësimit të territorit të tyre, pasi Riviera Shqiptare është në qendër të interesit kombëtar për zhvillim dhe investime në fushën e turizmit dhe rikreacionit.

Vetë komunitetet bregdetare kanë tendencë për të qendruar dhe zhvilluar pronën e tyre, edhe pse në shumë raste ato ndjehen të përjashtuara nga zhvillimi ekonomik, duke u vetë-identifikuar si mos përfitues të kësaj të drejte të komunitetit.

Qendrueshmëria e shfrytëzimit të këtij territori, kësajsoj edhe perspektiva zhvillimore në të ardhmen, është një çështje tjetër që meriton vëmendje. Në shumë raste, vetë komunitetet kanë qenë shkak i zhvillimit të disbalancuar, duke mos i konsideruar planet zhvillimor.

Plazhet janë një ndër burimet kresore të zhvillimit ekonomik në Shqipëri dhe në bregdetin e jugut shtrihet një pjesë e mirë e plazheve me ujin më të pastër në vend. Aty ndodhen 14 nga 25 plazhet me ujin me pastërti të lartë në nivel vendi dhe vetëm 2 nga 31 plazhet me ujin me pastërti të ulët<sup>1</sup>. Nga ana tjetër, nuk ka asnjë plazh me flamur blu, si certifikim për plazhe me zhvillim të qendrueshëm. Për të bërë një krahasim, Mali i Zi ka 25 dhe Greqia ka 430 plazhe me flamur blu<sup>2</sup>.

Në këto kushte, Shqipëria përballlet me dy sfida, të cilat mund të gjejnë zgjidhje në mënyrë të ndërthurur. Nga njëra anë fuqizimi ekonomik dhe rritja e përfshirjes së komuniteteve vendore dhe nga ana tjetër rritja e qendrueshmërisë së zhvillimit të plazheve.

Në vendin tonë marrja në përdorim e plazheve është e rregulluar nga një legjislacion i posaçëm<sup>3</sup> <sup>45</sup>. Gjithsesi, zbatimi në praktikë mbetet një ndër çështjet që shkakton debat dhe pakënaqësi në komunitete dhe bëhet bazë për përshkallëzim në episode konflikti të shprehur.

Në të shumtën e rasteve ky konflikt lidhet nga njëra anë me masën e përfshirjes së komuniteteve

bregdetare në vendimmarrjen lokale dhe nga ana tjetër me nivelin e transparencës, apo të komunikimit publik të çështjeve me karakter teknik-administrativ.

## **Cila mund të jetë një zgjidhje?**

Komunitet e zonave bregdetare kanë disa instrumente të vendimmarrjes të bazuara në traditë, që në shumë raste janë dhe pjesë e vendimmarrjes insitucionale vendore, si në rastin e kryesisë së fshatit që funksionon në mbështetje të funksioneve vetëqeverisëse të Bashkisë<sup>6</sup>, të cilat mund t'u japin përgjigje nga njëra anë rritjes së përfshirjes në zhvillimin e qendrueshëm të plazheve dhe nga ana tjetër uljes së konflikteve lidhur me marrjen në përdorim të tyre, duke rritur transparencën. Ky punim ka marrë në analizë një pjesë të territorit të Bashkisë Vlorë dhe Bashkinë Himarë.

## **Sa përfshihen komunitetet rurale bregdetare në administrimin e plazheve?**

Rastet janë të shumëllojshme dhe nga njëra anë varen nga karakteristikat shoqërore dhe ekonomike të komunitetit bregdetar të marrë në shqyrtim dhe nga ana tjetër nga karakteristikat e plazhit që bie në territorin e këtij komuniteti, nëse kemi të bëjmë me një zonë të mbrojtur apo me karakter strategjik.

Për t'i dhënë një përgjigje kësaj pyetje u mbështetëm në analizën e rregullores<sup>7</sup> dhe intervistave gjysëm të strukturuar në disa komunitete bregdetare në Bashkinë Vlorë dhe Himarë.

Në rregulloren më lart, që praktikisht përcakton kriteret se kush mund të marrë në administrim një plazh, nuk përcaktohet asnjë kriter për rritjen e përfshirjes së komuniteteve lokale bregdetare, pasi kriteret lidhen me eksperiençën e mëparshme për këtë lloj veprimtarie, me cilësinë e planit të biznesit, me profilin e aplikuesit për sa i përket detyrimeve tatimore dhe dënimeve apo proceseve në vazhdim, penale apo administrative<sup>7</sup>.

Përparësi mund t'u jepet vetëm subjekteve që ushtrojnë një aktivitet të lidhur me shfrytëzimin e plazhit, të cilat mund të mos jenë pjesë e komunitetit bregdetar, siç ndodh shpesh, ose sub-

jekteve fizike dhe juridike të tjera<sup>8</sup>. Në këtë pikë të fundit, rregullorja le hapësirë për interpretime, gjë që mund të përbëjë një avantazh për qëllimin tonë.

Intervali 200 m<sup>2</sup> deri në 5000 m<sup>2</sup> për sipërfaqet e stacioneve të plazhit<sup>9</sup> është shumë i madh dhe nuk ka një hapësirë interpretimi për rastet kur ekzistojnë komunitete bregdetare me fuqi ekonomike jo shumë të madhe, të cilat vihen në konkurrencë me investitorë të mëdhenj. Edhe pse, nga një analizë në terren, u konstatua që sipërfaqja minimale për t'u marrë në administrim mund të ishte 1000 m<sup>2</sup> dhe me një qera 1000 Lekë/m<sup>2</sup> për sezon, gjë që e rriste shumë pragun për investuesit e komunitetit bregdetar.

Një përfshirje më e madhe e komuniteteve bregdetare do të ishte e arsyeshme edhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në ligjin e posaçëm për turizmin, ku përcaktohet: "Turizmi dhe veprimtaritë e tjera të lidhura me të mbështeten në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Këto parime kanë të bëjnë me aspektet ekonomike, mjedisore e social-kulturore dhe kërkojnë vendosjen e një ekuilibri të drejtë ndërmjet këtyre tri dimensioneve, për të siguruar qëndrueshmërinë e zhvillimit afatgjatë."<sup>10</sup>

Në intervistat në komunitet bregdetar, në periudhën korrik-gusht 2016, shprehet nga njëra anë një mungesë reale e fuqisë së vendimmarrjes formale nëpërmjet kryesive të fshatit, të cilat nuk janë të përfshira në dijeninë e të intervistuarve në këto procedura, ashtu si dhe një përqendrim i vendimmarrjes në administratën e bashkive. Administratat e bashkive, në bazë edhe të rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit,"<sup>11</sup> përcaktohen si përgjegjëse për administrimin e kërkesave dhe dhënien e plazheve në administrim.

Nga ana tjetër, Ligji për Turizmin përcakton se kjo përgjegjësi duhet ushtruar në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit dhe me sugjerimet që rrjedhin nga takimet e Komitetit për Zhvillimin e Turizmit, ku gjithsesi komunitetet bregdetare nuk janë të përfaqësuara direkt. Kjo gjë mund të rregullohet më tej me udhëzim të ministrit përgjegjës<sup>12</sup>.

Gjithsesi, mungesa e vendimmarrjes formale

apo rolit këshillues për këtë çështje nga ana e kryesive të fshatit, që janë edhe të rregulluara në legjislacionin për pushtetin vendor, në njëfarë mënyre ul shpresat që mund të ketë një konsultim me komunitetet bregdetare tek personat e intervistuar. Kështu, një nga të intervistuarit shprehet "... kur nuk ka fuqi kryesia e fshatit apo kryeplaku për plazhet, sa mund të kenë ndikim mbledhjet e fshatit?"

Një fakt tjetër që del nga intervistat është se shumë nga hapësirat e plazhit janë marrë në administrim nga anëtarë të komunitetit bregdetar, por kjo nuk lidhet shumë me faktin që ata janë pjesë e atij komuniteti sesa me faktin që trajtohen si investitor në përgjithësi. Kjo në njëfarë mënyre ka ndikuar në uljen e ndërveprimeve ndërmjet vetë komunitetit. Kështu, edhe këtu një nga të intervistuarit shprehet "... po bëhen disa gjëra në plazhe dhe qendrat e banuara, shumë mirë që po bëhen, po njerëzit nuk kanë besim se do të jenë përfitues."

Ndërsa ndaj pyetjes se sa bashkëpunim ka brenda komunitetit, përgjigja më e zakonshme ishte "... më së shumti kujdesem për pronën time".

Përtej çështjes së përfshirjes së komuniteteve bregdetare në administrimin e plazheve lind pyetja: Sa i qëndrueshëm mund të jetë modeli aktual?

Një përgjigje vjen nga literatura: Një turizëm bregdetar i qëndrueshëm sigurohet nëse të ardhurat e krijuara nga turizmi do të inkurajojnë me stimuj direkt në nivel vendor konservimin e burimeve natyrore<sup>13</sup>.

### **A mund të rritet pjesëmarrja e komuniteteve rurale bregdetare në administrimin e plazheve?**

Duke pasur parasysh se rritja e përfshirjes ndikon në rritjen e qëndrueshmërisë së zhvillimit turistik të zonave bregdetare dhe më specifikisht të plazheve, duhet që komunitet të inkurajohen në këtë drejtim. Edhe bazuar në legjislacionin aktual, ka hapësirë për rritje e përfshirjes, sidomos duke ndikuar në pjesën e "ciklit të politikë-bërjes" ndërmjet "vendimmarrjes për zbatimin" dhe "zbatimit".

Aq më tepër që edhe në rekomandimet e

raporteve të BE për zhvillimin e zonave bregdetare përcaktohet se: Në nivel projekti/esh është e nevojshme përfshirja e komuniteteve dhe grupeve të interesit. Komuniteti lokal duhet të konsultohet në fazat e para dhe përgjatë zhvillimit konceptual të projektit, ndryshe ka risk të lartë që projekti të hidhet poshtë në fazat e mëvonshme<sup>14</sup>.

Një gjë e ngjashme ka ndodhur shpesh edhe në Shqipëri<sup>15</sup>. Është krijuar një ndjesi përjashtimi e shprehur në shumë episode të mediatizuara dhe që ka përshkallëzuar edhe në konflikte fizike me insitucionet ligj-zbatuese/rregulluese dhe investuesit.

Marrja në përdorim e plazheve dhe ngritja e stacioneve të plazheve në to duhet të shihet si një projekt në vazhdim nga bashkitë e reja, të cilave u shtohet risku për uljen e përfshirjes në vendimmarrje të këtyre komuniteteve, që deri dje ishin të vetë-administruara nga komuna, përgjithësisht me numër të vogël banorësh<sup>16</sup>.

Duke e kosideruar kështu do të jetë më e lehtë të përcaktohet një fillim dhe vazhdim i procesit (të rëndësishme këto edhe për monitorimin dhe vlerësimin në vazhdim të operatorëve), edhe pse në legjislacionin përkatës nuk ka një detajim të afateve kohore se kur mund të paraqitet kërkesë, apo se kur në afate periodike gjatë vitit zhvillohet një procedurë apo një tjetër.

Ndërkohë që çelja e stacionit të plazhit kërkohet të paktën gjatë afatit nga data 15 maj deri më 30 shtator të çdo viti dhe gjatë kësaj periudhe duhet të ofrojë të gjitha shërbimet dhe të përmbushë të gjitha kushtet minimale të përcaktuara në bazë të tipologjisë së plazhit ku do të ushtrohet aktiviteti<sup>17</sup>.

Lind pyetja, kush do të kujdeset për plazhin gjatë tetë muajve të tjerë? Po për përrrenjtë, që mbledhin papastërti, mbeturina organike dhe inorganike që mblidhen dhe dalin në det përgjatë gjithë vitit?

Këtu merr vlerë përcaktimi që i bën Fondacioni për Edukimin Mjedisor dhënies së flamurit blu, si një tregues për plazhe të qendrueshme<sup>18</sup>, një çmim mjedisor që u jepet komuniteteve të cilat bëjnë përpjekje për administrimin e ujrave bregdetare dhe plazheve në respekt të natyrës

dhe mjedisit vendor.

Për të marrë një flamur blu komunitetet dhe operatorët e plazheve duhet të përmbushin një sërë kriteresh që mbulojnë cilësinë e ujit, edukimin dhe informimin mjedisor, sigurinë, shërbimet dhe infrastrukturën.

Këto përpjekje bëhen nga komunitetet vendore për të siguruar që çdo pushues të mund të vizitojë ambiente të pastra dhe të sigurta në plazhet e përcaktuara për stacionet e plazhit. Gjithashtu, këto përpjekje sigurojnë që komuniteti vendor të ruajë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm. Akreditimi i plazheve është një tregues kyç dhe jep një vlerë të shtuar, kështu që komunitetet si pjesë përbërëse e të gjithë procesit kanë rëndësinë e vet.

Lind pyetja: *Pse komunitetet duhet të angazhohen kaq shumë për mbrojtjen e ujrave dhe ambientit, të investojnë në rrjetet e ujrave të zeza, të informojnë dhe edukojnë me fushata pastrimi, të informojnë turistët, apo të zbatojnë nisma të tjera, kur ato nuk janë përfitues në administrimin e plazheve?*

Fushatat për akreditim me flamurin blu bëhen nën përkujdesin e Komisionit Evropian dhe për këtë marrin vlerë edhe për Shqipërinë, në kuadër të procesit të integritimit<sup>19</sup>.

Nëse nga njëra anë analizojmë risqet dhe avantazhet e lidhura me përfshirjen e komuniteteve bregdetare në marrjen e plazheve në administrim për sa i përket zhvillimit të qendrueshëm dhe ruajtjes së mjedisit dhe cilësisë së ujrave; nga ana tjetër analiza jonë përqendrohet edhe në arsyet se pse rritja e përfshirjes rrezikohet nga rritja e pragut në akses, për sa i përket rrjedhës procedurale, por edhe për sa i përket kostove.

Kështu, komunitetet bregdetare që jetojnë në njësi të vogla, që në disa raste janë larg zyrave të bashkisë dhe nuk kanë zhdërvjelltësinë e duhur administrative dhe njohuritë ligjore për të përfituar nga shërbimet e bashkive të reja, apo nuk kanë burimet financiare për të marrë në administrim një plazh, pasi janë përgjithësisht të organizuar në baza familjare, rrezikojnë të mos kenë mundësi të marrin pjesë në procesin e kërkesës për marrjen e plazheve në administrim.

Këto çështje ulin përfshirjen e tyre dhe kështu ulin shanset për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm në këto zona. Turizmi i qëndrueshëm duhet të sigurojë nisma ekonomike praktike dhe afatgjata, duke siguruar përfitime shoqërore-ekonomike për të gjitha palët e interesit të cilat duhet të shpërndahen në mënyrë të drejtë, duke përfshirë këtu punësimin e qëndrueshëm dhe mundësitë për të ardhura dhe shërbime shoqërore për komunitetet pritëse, duke kontribuar në zbutjen e varfërisë<sup>20</sup>.

Megjithatë, ekzistojnë disa pika të forta mbi të cilat mund të ndërtohet një proces i qëndrueshëm projektesh për administrimin e plazheve.

Komunitetet bregdetare kanë tendencë të qendrojnë dhe janë të lidhur me territorin e tyre, gjë që shfaqet në mënyra të ndryshme. Moshat e mëdha jetojnë në mënyrë të theksuar traditën dhe janë rezidentë përgjatë gjithë vitit. Në moshat më të reja vihet re një fenomen i migracionit qarkullues apo sezonal. Gjithsesi, vullneti për të qendruar shprehet në investimin për të zhvilluar pronën. Nuk duhet anashkaluar edhe fakti që në zonat bregdetare të jugut ka pasur edhe migracion të brendshëm nga territore të tjera më pak të zhvilluara të vendit, niveli i integritit të cilave, edhe pse përgjithësisht i mirë, ndryshon sipas zonës.

Komunitet bregdetare janë krahasimisht të lidhur brenda vetes dhe ende kanë gjurmë të vendimmarrjes bazuar në traditë, jo-formale (këtu vatra komunitare e fshatit apo "rrapi" i sheshit qendror) që në shumë raste mund të jenë mbledhje sporadike apo të thirrura sipas zakoneve të njësisë administrative.

Por edhe pse jo-formale, aty formësohet përmbajtja e vendimmarrjes së komunitetit për shumë çështje, sidomos për sa i përket orientimit dhe influencimit të mbështetjes politike të individëve, institucioneve apo dhe vetë politikave në baza programore. Kjo pjesë është me shumë rëndësi, pasi është pikërisht nëpërmjet këtyre instrumenteve të vendimmarrjes që krijohet jo vetëm dakordësia, por edhe kundërshtimi ndaj një vendimi të institucioneve, kundërshtim ky që mund të orientohet drejt një aktivizmi konstruktiv qytetar për të influencuar vendimmarrjen.

Pra një zgjidhje për të rritur përfshirjen e komuniteteve bregdetare në marrjen në administrim të plazheve, duke rritur kështu qëndrueshmërinë zhvillimore të tyre, mund të ishte aktivizimi në këtë drejtim i kryesive të fshatit si organe këshillimore, që sëbashku me kryetarin e fshatit, të këshillojnë dhe ndërlidhin aparatet administrativ të bashkive të reja me komunitetet. Kjo gjë është e përcaktuar edhe në detyrat e tyre, që të kujdesen për zhvillimin ekonomik vendor, përdorimin e burimeve të përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale<sup>21</sup>. Kjo do të rriste përfshirjen sociale të komunitetit edhe për faktin që në bazë të traditës zakonore dhe praktikave, kryesia e fshatit/komunitetit përfaqëson zërin-vendimarrjen e fshatit/ komunitetit.

Këshilla e tyre me të vërtetë nuk është detyruese në përcaktimin e operatorit, por nga ana tjetër marrja në konsideratë e saj është garanci për një zhvillim të plazhit në harmoni me komunitetet bregdetare.

Për më tepër, bashkitë duhet të mbështesin komunitetet bregdetare për t'u organizuar në grupime operatorësh, apo nisma të tjera për rritjen e standarteve, në mënyrë që ata të kenë mundësi të konkurojnë me operatorët e mëdhenj. Kjo kërkon një balancë të madhe, pasi nga njëra anë nuk duhet prishur konkurrenca dhe nga ana tjetër duhet siguruar zhvillimi i qëndrueshëm. Këtu merr shumë rëndësi edhe marrja e vendimeve mbi bazën e evidencave, ku bota akademike mund të japë një kontribut të çmuar.

Përpyekjet duhet të shkojnë në drejtimin e një skenari të qëndrueshëm, që të jetë rezultat i shumatores së analizave shkencore, preferencave të shprehura nga komunitetet dhe strategjive vendore dhe kombëtare<sup>22</sup>.



## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

**Administrimi i plazheve nëpërmjet një modeli (sjelljeje) të ri të bazuar në traditën zakonore.**

Vendi ynë ka shumë rrugë përpara për të siguruar një zhvillim të qendrueshëm për sa i përket administrimit të plazheve dhe krijimit të stacioneve të plazheve konkurruese.

Administrimi i plazheve është përgjegjësi kryesisht e bashkive të reja të cilat duhet të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të garantuar që administrimi i të mirave publike të bëhet në mënyrë të qendrueshme për sa i takon zhvillimit ekonomik vendor, përdorimit të burimeve të përbashkëta dhe sigurimit të harmonisë sociale dhe ruajtjes së mjedisit.

Për këtë qëllim do të ishte i arsyeshëm një ndryshim sjelljeje nga ana e bashkive të reja për sa i përket dhënies në administrim të plazheve që kanë të bëjnë me:

- Konceptimin e procesit të dhënies në administrim të plazheve si një projekt me cikle, ku të ketë një fazë thirrjeje për shprehje interesi (që është kërkesa), një fazë shqyrtimi dhe vendimmarrjeje, të bazuar edhe në këshillat e kryesive të fshatit, apo konsultimeve publike, për atë që është vlerësimi i planit të biznesit dhe përfshirjes së komuniteteve. Këto mund të japin edhe dëshmi mbi respektimin real të kushteve dhe standarteve të stacioneve të plazhit për sa i përket sigurisë dhe cilësisë.

*Përcaktimi i fazave me afate do të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe aktivizimin e sa më shumë operatorëve.*

- Konsultimin e vazhdueshëm me komunitetet dhe rritjen e transparencës për sa i përket plane-

ve zhvillimore për turizmin, ashtu si dhe hapësirave të cilat mund të jenë të përshtatshme për shfrytëzimin për stacione plazhi. Instrumenti mund të jetë aktivizimi në këtë drejtim i kryesive të fshatit dhe vetë komuniteteve bregdetare, sipas modelit të bazuar në traditë.

*Organizimi i takimeve me komunitetet bregdetare në vendet e përcaktuara nga tradita si sheshi i fshatit, ku duhet të bëhet mbledhja e mendimeve për mënyrën më të mirë për marrjen në administrim të plazheve. Kjo do të sillte një rritje të përfshirjes së këtyre komuniteteve në vendimmarrje.*

- Rritja e kapaciteteve të komuniteteve bregdetare, apo përdorimi i formulave të bashkimit të operatorëve, ose krijimi i shoqatave komunitare, për të rritur shanset për marrjen në përdorim të plazheve nga vetë anëtarë të komuniteteve.

*Trajnimi i komuniteteve dhe krijimi i kushteve për bashkimin e tyre për të pasur kërkesa të suksesshme për marrjen në administrim të plazheve dhe zhvillimin e qendrueshëm të tyre.*

- Krijimi i komiteteve për menaxhimin e plazheve për plazhet ku mund të ngrihen stacione plazhi, të përcaktuara nga Këshilli Ministrave<sup>23</sup>, nën shembullin e kriterit 12 për akreditimin me flamurin blu.

- Rritja e bashkëpunimit me universitete apo institute me karakter shkencor, si për monitorimin e parametrave mjedisorë, shoqërorë dhe ekonomikë, ashtu dhe për dhënien e evidencave për vendimmarrjen për sa i përket zhvillimit të plazheve. Këto partnerë mund të rrisin besimin e komuniteteve tek bashkitë e reja, duke qenë institucione të pavarura.

## Burime

1. Agjencia Europiane e Mjedisit, State of Bathing Waters, 2015. <http://www.eea.europa.eu/themes/water/inter-active/bathing/state-of-bathing-waters>
2. Blue Flag, 2016. <http://www.blueflag.global/all-bf-sites/>
3. Ligj nr. 93/2015, datë 27.07.2015, "Për turizmin"; VKM nr. 369, datë 18.5.2016 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit"; dhe VKM nr. 31, datë 22.1.2014 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit".
4. VKM nr. 369, datë 18.5.2016 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit"
5. VKM nr. 31, datë 22.1.2014 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit"
6. Ligj nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Kreu XII "Funksionimi i strukturave komunitare në Bashki", Neni 70, Struktura komunitare në fshat.
7. VKM nr. 369, datë 18.5.2016 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", Neni 4, Kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, Pika 2 dhe 3.
8. VKM nr. 369, datë 18.5.2016 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", Neni 4, Kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, Pika 6.
9. VKM nr. 369, datë 18.5.2016 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", Neni 4, Kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, Pika 6.
10. Ligj nr. 93/2015, datë 27.07.2015, "Për turizmin", Neni 5, Parimet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit, Pika 1.
11. VKM nr. 369, datë 18.5.2016 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", Neni 4, Kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, Pika 5.
12. Ligj nr. 93/2015, datë 27.07.2015, "Për turizmin", Neni 20, Komiteti rajonal i zhvillimit të turizmit, Pika 1 dhe 3, si dhe Neni 24, Përgjegjësia për administrimin e burimeve turistike, Pika 2.
13. Center on Ecotourism and Sustainable Development, Global Trends in Coastal Tourism, , fq. 122-124, Dhjetor 2007.
14. The impact of tourism on coastal areas: regional development aspects. Faqe 46. Policy Department B: Structural and Cohesion Policies. Regional Development. 15/04/2008.
15. Panorama, grushte në Këshillin Bashkiak Himarë, përleshje gjatë mbledhjes, 30 Qershor 2016. <http://www.panorama.com.al/video-grushte-ne-keshillin-bashkiak-himare-perleshje-gjate-mbledhjes/>. 16. Ligj nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore".
17. VKM nr. 369, datë 18.5.2016 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", Neni 4, Kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, Pika 10.
18. <http://ec.europa.eu/ourcoast/download.cfm?file-ID=1018>
19. [http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-88-434\\_en.htm?locale=en](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-88-434_en.htm?locale=en)
20. Making Tourism More Sustainable - A Guide for Policy Makers, UNEP and UNWTO, 2005, f.11-12.
21. Ligj nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Kreu XII "Funksionimi i strukturave komunitare në Bashki", Neni 71, Detyrat dhe të drejtat e kryetarit dhe të kryesisë së fshatit, pika 1.
22. Sustainable Coastal Tourism/An integrated planning and management approach. Implementation Guide. Preparation of alternative scenarios for tourism development and definition of the Sustainable Scenario, f. 142, United Nations Environment Programme, 2009.
23. Ligj nr. 93/2015, datë 27.07.2015, "Për turizmin", Neni 64, Stacionet e plazhit, pika 2.